



KRU Hidroregjioni Jugor sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

Bordi i Drejtorëve në K.R.U "Hidroregjioni Jugor" SH.A me seli në Prizren, në përputhje me nenin 31 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe nenin 18 të Ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026, mori këtë:

VENDIM

RAPORTI VJETOR - 2025

Bordi i Drejtorëve miratoi Raportin Vjetor për vitin 2025 në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	UD. Kryeshef Ekzekutiv Fadil Berisha	Kryesuesi i BD Ylber Elshani
Nënshkrimi		
Data	27.02.2026	27.02.2026



KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com



RAPORTI VJETOR 2025



PËRMBAJTJA

I.	QËLLIMI	4
II.	METODOLOGJIA.....	4
III.	RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE.....	5
IV.	AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	9
V.	DEPARTAMENTI I UJIT TË PIJES.....	11
5.1	PRODHIMI m3.....	11
	PRODHIMI- REALIZIMI I CAQEVE- 2025.....	12
5.3	AKTIVITETET KRYESORE.....	13
5.3.1	AKTIVITETET PËR ZVOGLIMIN E HUMBJEVE TEKNIKE.....	16
5.3.2	MIRËMBAJTA - SANIMI I DEFEKTEVE.....	17
5.3.3	SERVISIMI I UJËMATËSAVE DHE DETEKTIMI	17
5.3.4	CILËSIA E UJIT	17
VI.	DEPARTAMENTI KOMERCIAL.....	19
6.1	PERFORMANCAT - 2025.....	19
6.1.1	NUMRI I KONSUMATORËVE.....	19
6.1.2	FATURIMI – m3	20
6.1.3	FATURIMI – €	23
6.1.4	ARKËTIMI – €.....	25
6.2	KOMENTET KRYESORE NGA DEPARTAMENTI KOMERCIAL.....	27
6.2.1	AKTIVITETET KRYESORE	27
	RAPORT PËR RASTET E DËRGUARA NË PËRMBARIM (Janar-Dhjetor 2025).....	28
	Problemet e hasura gjatë periudhës raportuese	28
	Konsumatorët që janë faturuar vetëm me tarif fikse për Dhjetor të viti 2025.....	29
	Masat e realizuara / mosrealizuara nga periudha paraprake.....	29
	Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	29
VII	DEPARTAMENTI I FINANCAVE	30
7.1	KOMENTET KRYESORE NGA DEPARTAMENTI I FINANCAVE.....	30
7.1.1	AKTIVITETET KRYESORE	30
7.1.2	ARSYESHMËRIA E SHPENZIMEVE	31
VIII	PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE	35
8.1	PERFORMANCAT 2024-2025	35

8.2	DRAFT PASQYRAT FINANCIARE – 2024-2025.....	36
IX	DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS.....	38
9.1	KOMENTET KRYESORE.....	38
9.2	ZYRA LIGJORE.....	40
X	DEPARTAMENTI I UN -ITUN	41
10.1	KOMENTET KRYESORE.....	41
10.1.1	FUSHËVEPRIMI I DEPARTAMENTIT TË -ITUN.....	41
	Aktivitetet e përgjithshme	43
	Aktivitetet kryesore gjatë vitit	44
XI	RAPORT NGA ZYRA E PROKURIMIT	48
XII	SFIDAT - 2025.....	56
XIII	MASAT E PROPOZUARA - 2025.....	57
XIV	ORGANOGRAMI.....	56

SHKURTESAT

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
BD	Bordi i Drejtorëve
KA	Komisioni i Auditimit
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
KNMU	Këshillit Ndërmintor për Ujëra
KRU	Kompania Rajonale e Ujësllësit
NJPMNP	Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
UPF	Uji i pa-faturuar
SIG	Sistemi Informativ Gjeografik
SHUKOS	Shoqata e Ujësllësve dhe Kanalizimit të Kosovës
NJOU	Njësia Operative e Ujësllësit
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujit të Ndotur.
NP	Ndërmarrjet Publike
DP	Departamenti i ujit
DK	Departamenti Komercial
KfW	Banka gjermane për zhvillim
TM	Tre mujori

I. QËLLIMI

Me anë të Raportit Vjetor gjithëpërfshirës për vitin 2025, Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti dhe punonjësit e tjerë të Kompanisë Rajonale të Ujit “Hidroregjioni Jugor” sh.a. paraqesin në mënyrë të saktë dhe transparente të gjitha faktet reale, arritjet, sfidat, vështirësitë dhe mësimet e nxjerra që kanë shoqëruar punën e ndërmarrjes gjatë periudhës 01.01.2025 – 31.12.2025. Ky raport ka për qëllim të informojë të gjitha palët e interesit mbi aktivitetet dhe zhvillimet kryesore të ndërmarrja gjatë vitit raportues, në radhë të parë Ministrinë e Ekonomisë në cilësinë e aksionarit, Bordin e Drejtorëve, autoritetet e pavarura, punonjësit e ndërmarrjes, konsumatorët, institucionet financiare, donatorët, si dhe publikun e gjerë. Përmes këtij raporti, menaxhmenti synon të sigurojë transparencë maksimale, duke prezantuar në mënyrë të plotë dhe të qartë aktivitetet, rezultatet dhe zhvillimet që kanë karakterizuar punën e ndërmarrjes gjatë vitit 2025. Parimi themelor që synohet të arrihet me këtë raport është forcimi i llogaridhënies ndaj të gjitha palëve të interesit, veçanërisht atyre të përfshira drejtpërdrejt në funksionimin dhe zhvillimin e ndërmarrjes.

II. METODOLOGJIA

Raporti është përpiluar duke u bazuar në Ligjin për Ndërmarrjet Publike (NP), Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, Udhëzuesin e Auditimit të Brendshëm për Ndërmarrjet Publike në Kosovë, si dhe në udhëzuesit e raportimit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU).

Gjithashtu, gjatë hartimit të raportit janë marrë në konsideratë praktikrat dhe përvojat pozitive nga raportet vjetore të viteve paraprake, njohuritë empirike, si dhe format dhe modelet e ndryshme të raportimeve të brendshme për menaxhmentin dhe raportimeve të jashtme për palët e interesit.

Me qëllim që raporti të jetë i qartë, i strukturuar dhe lehtësisht i kuptueshëm për të gjithë lexuesit, ai është ndërtuar mbi këto komponentë kryesore:

- pjesën tekstuale (përshkruese – narrative);
- pjesën tabelare me të dhëna numerike;
- pjesën grafike (paraqitje vizuale të treguesve).

Në raport janë bërë krahasime me vitin paraprak (2024), me Planin e Biznesit për vitin 2024, si dhe me caqet e miratuara nga ARRU, bazuar në aplikimin tarifor për Kompaninë Rajonale të Ujit.

Raporti gjithashtu merr në konsideratë dhe përfaqëson një përmbledhje (sintezë) të raporteve analitike të departamenteve dhe njësisve përkatëse brenda KRU “Hidroregjioni Jugor” sh.a., duke përfshirë raportet mujore dhe tremujore të të gjitha shërbimeve.

III. RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Emrat e drejtorëve të bordit të drejtorëve

KRU Hidroregjioni Jugor SH.A Prizren është udhëhequr nga Bordi i Drejtorëve i emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendim Nr. 02/258 të datës 16.04.2025.

Bordi i Drejtorëve fillimisht ka qenë i përbërë nga 4 drejtor në përbërje:

Ylber Elshani - Kryesues,

Agim Muqaj - anëtar,

Selvete Xhigoli - anëtare dhe

Sylejman Gashi - anëtar, (KA)

Informacione për Bordin e Drejtorëve gjatë vitit 2025

Raporti vjetor i Bordit të Drejtorëve në KRU "Hidroregjioni Jugor" SHA në Prizren, në formë përmbledhëse përfshinë aktivitetet kryesore të Bordit të Drejtorëve të realizuara gjatë muajve Prill - Dhjetor 2025.

Bordi i Drejtorëve gjatë muajve Prill - Dhjetor 2025 ka mbajtur dymbëdhjetë (12) takime të rregullta mujore.

KRU Hidroregjioni Jugor SH.A Prizren është duke u udhëhequr nga Bordi i Drejtorëve i emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendim Nr. 02/258 të datës 16.04.2025.

Bordi i drejtorëve është i përbërë nga katër (4) drejtorë të cilët janë: Ylber Elshani - Kryesues, Agim Muqaj - anëtar, Selvete Xhigoli – anëtare dhe Sylejman Gashi – anëtar.

Gjatë vitit 2025 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur 12 takime të rregullta.

Në këto takime Bordi i Drejtorëve përveç diskutimeve të frytshme poashtu ka marrë veprimet si vijon:

- Miratoi kërkesën për rritjen e pagave në vlerën 50.00 euro bruto;
- Miratoi raportin TM3 – 2024;
- Miratoi raportin TM4 – 2024;
- Miratoi raportin vjetor – 2024;
- Miratoi Plan Biznesin 2025 – 2027;
- Miratoi Rregulloren për Kodin e Etikës dhe Procedurën Disiplinore për të Punësuarit në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, me seli në Prizren;
- Miratoi raportin për hulumtimin e kënaqshmërisë së konsumatorëve për periudhën Janar – Dhjetor 2024;
- Miratoi raportin TM1 – 2025;
- Miratoi pasqyrat financiare dhe raportin e auditorit të pavarur 31 dhjetor 2024;
- Miratori rishikimin (revidimin) e Plan Biznesit 2025 – 2027;
- Miratoi Rregulloren për Inicimin e Procedurës Përmbarimore te Organi Përmbarues e K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, me seli në Prizren;

- Miratoi raportin TM2 – 2025;
- Miratoi kërkesën për rritjen e shujtës ditore për punëtorët e kompanisë;
- Miratoi Rregulloren për për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës si dhe koeficientet e pagave për të gjitha pozitat e punës në K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” Sh. A. Prizren;
- Miratoi Plan Biznesin 2026 – 2028;
- Miratoi raportin TM3 – 2025;
- Miratoi kërkesën për ndarjen e bonusit si shpërblim për fundvit për të gjithë punëtorët e kompanisë;
- Miratoi Planin e Sigurisë së Ujit.

MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN

(të Emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 02/258 të datës 16.04.2025)

Numri i takimeve të Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2025

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	29.04.2025	Prizren	
2	12.05.2025	Prizren	
3	28.05.2025	Prizren	
4	30.06.2025	Prizren	
5	30.07.2025	Prizren	
6	29.08.2025	Prizren	
7	29.09.2025	Prizren	
8	14.10.2025	Prizren - MPVA	
9	31.10.2025	Prizren	
10	26.11.2025	Prizren	
11	19.12.2025	Prizren	
12	30.12.2025	Prizren	

MBLEDHJET E KOMISIONIT TË AUDITIMIT

(të Emëruar nga Ministrija e Ekonomisë me vendimin Nr.4316 të datës 07.11.2025)

Numri i takimeve të Komisionit të Auditimit

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	24.11.2025	Prizren	
2	24.12.2025	Prizren	

Aktivitetet tjera të Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2025

- Bordi i Drejtorëve prej emërimit me datë: 16.04.2025 ishte në kontakt të vazhdueshëm me Menaxhmentin e Kompanisë.
- Në vazhdimësi ka kërkuar dhe është njoftuar, në kontakt direkt por edhe në formë të shkruar, për gjendjen dhe zhvillimet në kompani.
- Është mbikëqyrë menaxhimi kompanisë dhe janë dhënë këshillat e nevojshme për Kryeshefin Ekzekutiv.
- Në takimet e rregullta janë mbikëqyrë të gjitha ecuritë e biznesit, mbarëvajtja e tyre sipas vendimeve të Bordit si dhe aspekti ligjorë i vendimeve të Menaxhmentit të kompanisë. Lidhur me këtë Bordi i Drejtorëve është i informuar për të gjitha vendimet dhe zhvillimet e rëndësishme.
- Është bërë shqyrtimi dhe aprovimi i raporteve tremujore për vitin 2024 dhe 2025 (duke u bazuar në raportet mujore); dhe në kornizën ligjore të Ligjit për NP.
- Janë dorëzuar në NJPMNP të aprovuara raportet si në vijim: Raporte tremujore për aksionarin (ME); (raporti TM3 - 2024, TM4 - 2024, raporti vjetor 2024, Raporti i auditimit nga auditori i pavarur për vitin 2024, raporti TM1 – 2025, TM2 – 2025, TM3 - 2025) dhe raporte mujore për ARRU-në.

Bordi i Drejtorëve i falënderon Kryeshefin Ekzekutiv, stafin menaxhues të Kompanisë dhe të gjithë punëtorët për angazhimin e tyre në rritjen e performancës së kompanisë dhe në përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve. Bordi shpreh një mirënjohje të veçantë për të gjithë donatorët KFW, ME dhe Komunitat e zonës së shërbimit për bashkëpunim dhe mbështetje në realizimin e shumë projekteve për interes të qytetarëve dhe të Kompanisë.

Raport vjetor i punës së Komisionit të Auditimit për vitin 2025.

Raporti vjetor i Komisionit të Auditimit të K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, me seli në Prizren, në formë përmbledhëse përfshin aktivitetet kryesore të Komisionit të Auditimit të realizuara gjatë vitit 2025.

Bazuar në procesverbalet zyrtare të mbajtura, gjatë këtij viti, janë mbajtur dy (2) takime të Komisionit të Auditimit.

Takimi i parë i Komisionit të Auditimit është mbajtur me datë 24.11.2025, me përbërje të plotë të 3 anëtarëve, Sylejman Gashi – Kryesues i Komisionit të Auditimit, Agim Muqaj - anëtarë dhe Selvete Xhigoli – anëtare.

Në këtë takim, janë diskutuar dhe shqyrtuar disa tema, me ç'rast edhe janë marrë vendime, të paraqitura si në vijim:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Konstituimi i Komisionit të Auditimit;
3. Shqyrtimi i draft – raportit TM3 – 2025;
4. Të ndryshme.

Në këtë takim Komisioni i Auditimit:

- Rekomandon menaxhmentin dhe Bordin e Drejtorëve që gjatë vitit 2026 të bëhet hartimi i planit për menaxhimin e rreziqeve. Zyra e Auditimit të Brendshëm bazuar në këtë plan e ka parasysh se ku janë rreziqet më të mëdha dhe planifikon që në fushat të cilat kanë rrezikshmëri më të madhe të përqendrohet më shumë.

Takimi i dytë i Komisionit të Auditimit është mbajtur me datë 24.12.2025, me përbërje të plotë të 3 anëtarëve të K.A.

Në këtë takim, janë diskutuar dhe shqyrtuar disa tema të paraqitura si në vijim:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Diskutimi i raporteve të auditimit pas konstituimit të Komisionit të Auditimit;
4. Diskutimi dhe aprovimi i planeve të Auditimit të Brendshëm (AB), plani vjetor 2026 dhe plani strategjik 2026 – 2028;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim ndryshimit të statutit të AB;
6. Vendimi për Planin e Sigurisë së Ujit dhe
7. Të ndryshme.

Në këtë takim Komisioni i Auditimit:

- Shqyrtoi raportet e auditimit të brendshëm, të gjeturat dhe rekomandimet e Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm;
- Miratoi Planin Vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2026;
- Rekomandoi Bordin e Drejtorëve për aprovimin e Planit të Sigurisë së Ujit.

Anëtarët e Komisionit të Auditimit në K.R.U “Hidroregjioni Jugor” Sh.A - Prizren

- Sylejman Gashi, kryesues
- Selvete Xhigoli, anëtare
- Agim Muqaj, anëtar

IV. AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Gjatë vitit 2025, Kryeshefi Ekzekutiv i KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a. ka ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me legjislacionin në fuqi, politikat e ndërmarrjes dhe vendimet e Bordit të Drejtorëve, duke udhëhequr dhe koordinuar aktivitetet strategjike, operative dhe zhvillimore të kompanisë.

Në bashkëpunim të ngushtë me menaxhmentin dhe departamentet përkatëse, janë realizuar aktivitetet në vijim:

- Formimin e Task Force për zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të masave për menaxhimin e Ujit të Pa Faturuar (UPF).
- Menaxhimin e situatave emergjente të shkaktuara nga defekte të paparashikuara në rrjetin kryesor të furnizimit, përfshirë dëmtimet nga operatorë ekonomikë gjatë investimeve të financuara nga donatorët (KfW), Ministria e Infrastrukturës dhe komunat.
- Nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet KRU "Hidroregjioni Jugor", Ministrisë së Ekonomisë, ARRU, komunave në zonën e shërbimit, universiteteve dhe Postës së Kosovës.
- Organizimin e takimeve të rregullta të menaxhmentit dhe koordinimin e aktiviteteve me SHUKOS, ARRU, donatorët dhe partnerët zhvillimorë.
- Takime të rregullta me kryetarët e komunave Prizren, Suharekë, Malishevë dhe Dragash, si dhe me përfaqësues të fshatrave dhe lagjeve, për adresimin e çështjeve të furnizimit dhe investimeve.
- Pjesëmarrjen dhe koordinimin në projektin rajonal të Ballkanit Perëndimor "Kompanitë Rajonale të së Ardhmes", të mbështetur nga Banka Botërore dhe SECO, për transformimin e shërbimeve të ujit dhe sanitetit.
- Organizimin dhe realizimin e aktiviteteve në kuadër të Ditës Botërore të Ujit dhe promovimin e ndërgjegjësimit publik për menaxhimin e burimeve ujore.
- Pjesëmarrjen në takime pune me Komisionin Parlamentar të Kosovës dhe institucionet e sektorit të ujit për adresimin e sfidave të sektorit.
- Mbikëqyrja e furnizimit të qëndrueshëm me ujë të pijshëm në të gjitha njësitë operative, përfshirë menaxhimin e reduktimeve sezonale dhe optimizimin e shpërndarjes së ujit.
- Koordinimi i aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve prodhuese të ujit, përfshirë hapjen e puseve të reja dhe integrimin e burimeve alternative në sistem si dhe rehabilitimin e burimeve ekzistuese ujore në burimin "40 burimet" dhe Galeria I & 2.
- Mbikëqyrja e rehabilitimit dhe zgjerimit të rrjetit të ujësjellësit në zonat me furnizim të paqëndrueshëm dhe me prishje të shpeshta.
- Nxitja e krijimit të zonave DMA dhe vendosja e ujëmatësve të prodhimit dhe konsumit për kontroll më të mirë të humbjeve dhe balancës së ujit.
- Mbështetja e implementimit të Planit të Veprimit për Ujin e Pa Faturuar (UPF) dhe monitorimi i rezultateve në nivel kompanie.

- Mbikëqyrja e funksionimit të Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Ndotura në Prizren dhe monitorimi i proceseve të trajtimit sipas standardeve mjedisore.
- Koordinimi i projektit “Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në qytetin e Prizrenit – Faza V dhe VI” dhe bashkëpunimi me konsulencën, kontraktorët dhe KfW-në.
- Mbështetja e implementimit të metodave moderne të rehabilitimit të kanalizimit (INLINING) dhe kontrolli i kyçjeve përmes teknologjisë CCTV.
- Monitorimi i projekteve kapitale në sektorin e ujërave të ndotura në Malishevë dhe Suharekë dhe sigurimi i realizimit sipas planifikimeve.
- Koordinimi i aktiviteteve për mirëmbajtjen e kolektorëve, interceptoreve dhe objekteve të trajtimit për parandalimin e bllokimeve dhe ndotjeve.
- Ndjekja e procedurave për pajisjen me leje ujore dhe përputhjen me kërkesat e autoriteteve mjedisore.
- Udhëheqja e proceseve për përgatitjen dhe revidimin e Planit të Biznesit dhe Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH 2026–2028).
- Mbikëqyrja e performancës financiare dhe monitorimi i të hyrave dhe shpenzimeve për sigurimin e qëndrueshmërisë ekonomike të kompanisë.
- Koordinimi i proceseve për regjistrimin e aseteve kapitale dhe përfshirjen e projekteve në bazën rregullatore të aseteve.
- Bashkëpunimi me donatorët dhe institucionet financiare për menaxhimin e fondeve dhe raportimin financiar të projekteve.
- Mbështetja e aktiviteteve për rritjen e inkasimit dhe përmirësimin e disiplinës së pagesave nga konsumatorët.
- Mbikëqyrja e proceseve të faturimit, leximit të ujëmatësve dhe menaxhimit të borxheve, përfshirë procedurat përmbartimore.
- Koordinimi i masave për identifikimin dhe legalizimin e konsumatorëve pa kontratë dhe luftimin e lidhjeve ilegale.
- Mbështetja e aktiviteteve për përmirësimin e shërbimit ndaj konsumatorëve dhe trajtimin e ankesave për furnizim dhe faturim.
- Nxitja e transparencës përmes dëgjimeve publike dhe komunikimit të rregullt me komunitetin.
- Mbikëqyrja e implementimit dhe përdorimit të sistemeve digjitale (SISHU, MMS, GIS) për menaxhimin e aseteve dhe raportimin e të dhënave operative.
- Nxitja e digjitalizimit të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe përmirësimi i bazës së të dhënave për planifikim dhe vendimmarrje.
- Përfaqësimi i kompanisë në takime me ARRU, Ministrinë e Ekonomisë, MMPHI, komunat në zonën e shërbimit, Bankën Botërore, KfW dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë.
- Koordinimi i bashkëfinancimeve me komunat për projekte infrastrukturore dhe zgjerimin e mbulueshmërisë së shërbimeve.
- Menaxhimi i situatave emergjente dhe koordinimi me institucionet përkatëse për reagim të shpejtë ndaj krizave në sistem.

- Mbikëqyrja e proceseve të sistematizimit të vendeve të punës dhe përmirësimit të strukturës organizative.
- Nxitja e zhvillimit profesional të stafit përmes trajnimeve dhe programeve të ngritjes së kapaciteteve.
- Vlerësimi i performancës së stafit dhe forcimi i kulturës së përgjegjësive dhe profesionalizmit.


V. DEPARTAMENTI I UJIT TË PIJES

5.1 PRODHIMI m3

Tabela nr. 1 – Prodhimi – 2024-2025 dhe Caqet 2025

JANAR-DHJETOR - 2025				
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A - PRIZREN				
P R O D H I M I - m3				
NJËSIA PUNUESE	2024		2025	
	l/sec	m3	l/sec	m3
PRIZREN	740.6	23,354,070	864.1	27,251,679
SUHAREKË	141.8	4,473,192	146.3	4,612,371
MALISHEVË	77.4	2,441,429	77.4	2,440,781
DRAGASH	29.1	917,439	26.2	825,748
TOTAL	988.9	31,186,130	1,114.0	35,130,579
NDRYSHIMI l/sec			125.1	3,944,449
NDRYSHIMI %			12.65 %	12.65 %

Diagrami nr. 1 – Prodhimi – 2024-2025 dhe Caqet 2025




PRODHIMI- REALIZIMI I CAQEVE- 2025

Tabela nr. 2 – Prodhimi - Caqet 2025

JANAR-DHJETOR - 2025				
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A - PRIZREN				
P R O D H I M I - m ³				
NJËSIA PUNUESE	2025		2025 (PB)	
	l/sec	m ³	l/sec	m ³
PRIZREN	864.1	27,251,679	786.5	24,804,164
SUHAREKË	146.3	4,612,371	142.2	4,485,498
MALISHEVË	77.4	2,440,781	78.9	2,487,187
DRAGASH	26.2	825,748	27.3	861,492
TOTAL	1,114.0	35,130,579	1035.0	32,638,341
NDRYSHIMI l/sec			-79	- 2,492,238
NDRYSHIMI %				-7.09%

Diagrami nr. 2 – Prodhimi – Caqet PB 2025



Koment për prodhimin e ujit:

1. Mos kalkulim i rrjedhjeve (humbjeve te autorizuar) si pasoje e defekteve ne rrjetin furnizues.
2. Vendosja e ujematesit ne gypin (Ø600mm) kryesore i cili furnizon qytetin te Prizrenit.
3. Vendosja e gjenatoreve, te cilet kane mundesuar prodhim te pa-nderprere, krahasur me vitet paraprake.
4. Rehabilitimi i burimeve kryesore te cilat kane rritur sasine e ujit.
5. Rritja e kerkeses per uje, kryeisht ne muajt e verese si rezultat i temperaturave ekstreme.
6. Pastrimi i rrjetit per shkak te futjes se turbullires ne sistemin shperndares.

5.2 SITUATA E FURNIZIMIT

Furnizimi i konsumatorëve me ujë të pijshëm gjatë periudhës janar–dhjetor 2025, në nivel rajonal dhe në të gjitha njësitë punuese dhe operative, ka qenë kryesisht i rregullt, ndërsa në disa zona ka qenë pjesërisht i rregullt. Gjatë periudhave të caktuara, veçanërisht në stinën e verës dhe të vjeshtës, janë aplikuar reduktime të përkohshme në zona të ndryshme me qëllim të sigurimit të furnizimit sa më të barabartë me ujë për të gjithë konsumatorët.

Ky fenomen është shfaqur kryesisht si pasojë e rënies së nivelit të ujit në burime, kushteve të pafavorshme gjeografike dhe amortizimit të infrastrukturës së rrjetit shpërndarës.

Në krahasim me vitin paraprak, furnizimi gjatë muajve janar–dhjetor 2025 ka qenë relativisht i qëndrueshëm. Megjithatë, ndërprerjet e shpeshta të energjisë elektrike kanë ndikuar negativisht në përmbushjen e standardit optimal të furnizimit 24-orësh me ujë të pijshëm në disa zona të shërbimit. Pavarësisht masave të ndërmarra, si përdorimi i gjeneratorëve rezervë, operimi dhe mirëmbajtja e shtuar, si dhe monitorimi intensiv i sistemit të ujësjellësit, janë hasur vështirësi në arritjen e furnizimit plotësisht të qëndrueshëm.

Kompania vazhdon të ndërmarrë masa për modernizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës hidroteknike dhe elektromekanike, me synim sigurimin e një furnizimi të qëndrueshëm dhe cilësor me ujë për të gjithë konsumatorët në zonën e mbulimit.

Përpjekjet për realizimin e investimeve kapitale janë intensifikuar, duke synuar zgjidhjen afatgjatë të problemeve teknike dhe të infrastrukturës së vjetruar, si dhe menaxhimin më efikas të burimeve ujore në kushtet aktuale klimatike.

5.3 AKTIVITETET KRYESORE

- Angazhimet dhe menaxhimi i përditshëm i punëve, konform detyrimeve dhe përgjegjësi të vendit të punës dhe jashtë tyre, për operimin dhe funksionimin optimal të Departamentit të Ujit të Pijes në veçanti dhe të Kompanisë në përgjithësi.
- Mbajtja e takimeve të rregullta ditore, javore dhe mujore të menaxhmentit me bashkëpunëtorët, udhëheqësit e njësive punuese në varësi dhe shërbimet tjera të Kompanisë.
- Takime të rregullta javore me udhëheqësit e njësive punuese me qëllim koordinimin e aktiviteteve në zona të caktuara për zvogëlimin e humbjeve të ujit.
- Takime me institucione komunale, qeveritare, institucione financiare donatore, operatorë ekonomikë, konsumatorë dhe palë të tjera të interesit.
- Hartimi i raporteve të rregullta dhe specifike, përgjigjeve zyrtare, shkresave, komenteve dhe komunikimeve elektronike e fizike për menaxhmentin, Komitetin Ekzekutiv, Bordin e Drejtorëve, ARRU, IM, KNMU dhe institucionet e tjera monitoruese dhe ndërvepruese në sektorin e ujit dhe energjisë.

- Përgatitja e raportit final mujor nga DUP lidhur me furnizimin, prodhimin, humbjet e ujit, të dhënat tjera raportuese dhe pasqyrën detale të projekteve kapitale të realizuara me mjete vetanake dhe donatore, duke evidentuar statusin e secilit projekt veç e veç.
- Monitorimi dhe menaxhimi profesional i stacioneve dhe sistemeve elektropompuese, si dhe shërbimeve për mirëmbajtjen dhe operimin e tyre, përfshirë përpilimin e raporteve përkatëse.
- Dorëzimi në DSHP–Prizren i projektit për rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Lutogllavë, Komuna e Prizrenit.
- Përmbyllja e projekteve sipas PB-2024 dhe regjistrimi i tyre si asete të Kompanisë.
- Takim me përfaqësues të KK-Prizren dhe operatorë ekonomikë për projektin “Hartimi i projektit detal për rritjen e kapacitetit të ujit duke shfrytëzuar burimet Vërmicë dhe Poslisht”.
- Shtimi i masave të sigurisë dhe vizita më të shpeshta në burimet e ujit, si dhe raportimi i rregullt për gjendjen e tyre.
- Takim me banorët dhe përfaqësuesit e fshatit Pouskë lidhur me kërkesën për rehabilitimin e rrjetit furnizues, i dëmtuar nga punëkryerësi i angazhuar nga ministria.
- Takim me përfaqësues të lagjes Bajram Curri lidhur me protestën në objektin e KRU-HRJ dhe kërkesën për largimin e reduktimeve të ujit.
- Hartimi i dokumentit “Plani i Menaxhimit të Ujëmatësve” (PMU).
- Takim me WRIPS.
- Marrëveshje bashkëfinancimi ndërmjet KRU-HRJ dhe KK-Prizren për rehabilitimin e rrjetit të vjetruar të ujësjellësit.
- Trajtimi i problemit të kapërderdhjes së ujit nga rezervuarët.
- Takim me Kryetarin e Komunës së Prizrenit dhe prezantimi i Raportit Vjetor 2024 të KRU-HRJ.
- Takim me banorët e Hoqës së Qytetit lidhur me kërkesën për të hyrë në menaxhim të KRU-HRJ.
- Takim me përfaqësues të Bankës Botërore në zyrat e HRJ, në kuadër të programit UoF.
- Takim me përfaqësues të ARRU me temë fillimin e implementimit të platformës SISHU.
- Punëtori me ARRU: “Procedurat e përcaktimit të tarifave 2026–2028”.
- Hartimi i dokumentit “Plani i Sigurisë së Ujit” (PSU).
- Komente dhe kontribute për plotësimin e programit MMS.
- Fillimi i azhurnimit të dokumentit “Plani i Veprimit për UPF 2025” dhe implementimi i tij.
- Takim me AMK lidhur me kërkesën për tërheqjen e pajisjes së kalibrimit nga objekti i KRU-HRJ.

- Caktimi i komisionit sipas kërkesës së AMK dhe adresimi zyrtar për shtyrjen e afatit të tërheqjes së pajisjes.
- Takim me QRTK për diskutimin e mundësive të rehabilitimit të objektit të KRU-HRJ në zonën e mbrojtur "Shadervan".
- Vendosja e ujëmatësit mekanik Ø500 mm në gypin kryesor furnizues të qytetit të Prizrenit.
- Takim me banorët e lagjes Terzimahalla lidhur me ankesat për furnizim të paqëndrueshëm me ujë.
- Krijimi i DMA-zonës "Bajram Curri" nga sektori i GIS-it.
- Takim me KK-Prizren (DSHP) për investimet në rehabilitimin e ujësjellësit në lagjen Arbana.
- Takime me stafin operativ në Prizren lidhur me pakënaqësitë e paraqitura dhe anulimin e protestës nga punëtorët.
- Plotësimi dhe dërgimi i të dhënave për projektin "Resilienca Klimatike në sektorin e Ujit në Kosovë".
- Monitorimi i implementimit të platformës MMS për operim dhe mirëmbajtje.
- Takim në terren me punëkryerësin e projektit rrugor Prizren–Tetovë lidhur me dëmtimin e gypit që furnizon rezervuarin "Tusuz".
- Takim me përfaqësues të MMPHI për mundësinë e financimit të devijimit të gypit Ø160 mm në Pouskë.
- Takim me Kryetarin e Komunës së Dragashit për investimin në sistemin e ujësjellësit dhe fabrikën e prodhimit të ujit që do të furnizojë rreth 15 fshatra.
- Plotësimi i formularit për Aplikimin Tarifor 2026–2028 dhe takime të rregullta për rishikimin e Planit të Biznesit 2025.
- Vazhdimi i ndryshimeve në "Rregulloren për Sistematizimin e Vendeve të Punës".
- Takim me përfaqësues të KFOR-it.
- Punëtori me KK-Prizren: "Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) 2025–2035".
- Takim i PIU për projektin "Resilienca Klimatike në sektorin e Ujit në Kosovë".
- Takim informues për fillimin e punimeve në projektin: "Studimi i fizibilitetit për furnizim me ujë të pijshëm për Komunën e Malishevës".
- Takim me përfaqësues të fshatit Gërçar lidhur me shqetësimet për vonesën e implementimit të projektit.
- Ndërhyrje në gypin transportues Ø160 mm që furnizon lagjen Arbana, duke zgjidhur një problem shumëvjeçar të furnizimit.
- Fillimi i furnizimit të fshatit Vlashnje nga sistemi i qytetit, pas ndërprerjes së furnizimit nga STP "SOZI".
- Pjesëmarrje në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Prizrenit për prezantimin e raportit 6-mujor.
- Takim në ARRU lidhur me materialin e dorëzuar për aplikimin tarifor 2026–2028.
- Organizimi i dëgjimit publik për aplikimin tarifor 2026–2028.

- Trajtimi i problemeve me kapërderdhjen e rezervuarëve për shkak të dështimit të sistemit komunikues.
- Vendosja e gypave Ø110 mm dhe Ø63 mm (baj-pas) për furnizimin e rezervuarit "Tusuz" dhe fshatit Pouskë, si pasojë e rrëshqitjes së dheut.
- Realizimi i projekteve sipas Planit të Biznesit 2025, përfshirë:
 - hapjen e puseve në Doberdelan (Suharekë) dhe Bellanicë (Malishevë);
 - rehabilitimin dhe zgjerimin e sistemeve të kanalizimit në Suharekë dhe Malishevë;
 - digjitalizimin e rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit në Prizren dhe Suharekë;
 - zgjerimin e rrjetit dhe vendosjen e ujëmatësve në lagjen Dardania 2 – Faza I;
 - rehabilitimin e rrjetit në rrugën "Xheme Gostivari" – Prizren;
 - rehabilitimin e rrjetit dhe vendosjen e ujëmatësve në rrugën "Imer Krasniqi" – Malishevë;
 - zgjerimin dhe integrimin e burimeve të reja në sistem në fshatin Gërçar – Faza III;
 - rehabilitimin e gypit Ø400 mm dhe integrimin e burimit alternativ në sistem;
 - ndërtimin e objektit të klorinimit dhe rehabilitimin e kaptazhës IV në "40 Burimet";
 - vazhdimin e studimit të fizibilitetit për furnizim me ujë të pijshëm për Komunën e Malishevës.

5.3.1 AKTIVITETET PËR ZVOGLIMIN E HUMBJEVE TEKNIKE

Gjatë vitit 2025, KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. ka realizuar aktivitete të rëndësishme në funksion të përmirësimit të menaxhimit të shërbimeve të ujësjellësit, rritjes së efikasitetit operacional dhe reduktimit të humbjeve të ujit, në përputhje me Planin e Veprimit për vitin 2025.

Është realizuar konsolidimi i databazës së konsumatorëve përmes identifikimit dhe regjistrimit të konsumatorëve të paregjistruar, përditësimit dhe harmonizimit të të dhënave, si dhe verifikimit të rasteve me konsum zero, me qëllim rritjen e saktësisë së të dhënave dhe përmirësimin e performancës komerciale.

Në kuadër të reduktimit të konsumit të paautorizuar, janë zhvilluar inspektime sistematike për zbulimin dhe trajtimin e kyçjeve ilegale.

Është përmirësuar procesi i faturimit përmes kontrollit të saktësisë së leximeve, zëvendësimit të ujëmatësve jofunksional dhe mirëmbajtjes së databazës së integruar të ujëmatësve.

Në drejtim të zvogëlimit të humbjeve teknike, kompania ka forcuar mekanizmat për evidentimin dhe riparimin e rrjedhjeve të dukshme dhe nëntokësore, si dhe ka avancuar menaxhimin përmes krijimit dhe monitorimit të zonave të matura (DMA), duke mundur analizë më të saktë të bilancit ujqor.

Gjithashtu, janë realizuar investime në rehabilitimin dhe zëvendësimin e infrastrukturës së ujësjellësit me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe reduktimin e humbjeve në rrjet.

Këtij raporti i bashkëngjitet edhe Tabela në excel të aktiviteteve të realizuara gjatë vitit raportues, në përputhje me Planin e Veprimit për vitin 2025.

Si shtojcë e këtij raporti është paraqitur: Raporti i UPF-së sipas planit të veprimit për vitin 2025.

5.3.2 MIRËMBAJTA - SANIMI I DEFEKTEVE

Tabela nr. 3 – Sanimi i defekteve- 2025

Njësia Operative	Ujësllësi - uji i pijes
Prizren	1,611
Suharekë	324
Dragash	73
Malishevë	232
Total	2,240

Koment: Numri i intervenimeve, sanimi i defekteve, ne krahasim me vitin 2024 është zvogluar në 37.6 % (- 1,349)

5.3.3 SERVISIMI I UJËMATËSAVE DHE DETEKTIMI

Tabela nr. 4 – Servisimi i ujëmatësave - 2025

Aktivitetet/Grupet - e menaxhuar nga Departamenti i Ujit të Pijes (DUP)		
Grupet	Aktivitetet e grupeve gjatë muajve Janar-Dhjetor, 2025	
Kalibrim i ujëmatësve	273	riparime të ujëmatësave
Ndërrimi i ujëmatësve (D-M)	1945	vizita të konsumatorët
	1148	ndërrime të ujëmatësave
	335	riparim të defekteve gjatë ndërrimit
Detektimit të rrjetit	731	detekttime
	491	defekte të gjetura
	41,920	rrjet i detektuar (m)

5.3.4 CILËSIA E UJIT

- Kontrolli i vazhdueshëm i prezencës së klorit residual në rrjetin e shpërndarjes (kroje publike) në qytet dhe në fshatra, me qëllim garantimin e dezinfektimit të duhur të ujit të pijshëm dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

- ☒ Kontrolli i vazhdueshëm i cilësisë së ujit në burime dhe në puset që aktualisht shfrytëzohen për furnizim, përmes analizave fiziko-kimike dhe mikrobiologjike, në përputhje me standardet në fuqi.
- ☒ Kontrolli i rregullt i stacioneve të klorinimit, duke përfshirë verifikimin e procesit të dozimit, funksionimin e pajisjeve dhe sigurinë operationale të sistemeve të dezinfektimit.
- ☒ Furnizimi i rregullt i stacioneve të klorinimit me hipoklorit natriumi në të gjitha zonat e shërbimit, duke siguruar vazhdimësi në procesin e dezinfektimit të ujit.
- ☒ Marrja e mostrave të ujit sipas Planit të Monitorimit të Cilësisë së Ujit, përfshirë pikat kritike në rrjet, burimet dhe rezervuarët, si dhe dokumentimi dhe raportimi i rezultateve për institucionet përkatëse.
- ☒ Ndërmarrja e masave korrigjuese të menjëhershme në rast të devijimeve nga standardet e cilësisë së ujit, duke përfshirë rregullimin e dozimit të klorit, shpëlarjen e rrjetit dhe njoftimin e strukturave përgjegjëse.

Tabela nr. 5 – Analizat e ujit - 2025

NJËSIA	Lloji i ujit	Numri i mostrave	Numri i mostrave të dështuara
PRIZREN	Ujësjiellës	1,738	6
DRAGASH	Ujësjiellës	116	8
SUHAREKË	Ujësjiellës	264	2
MALISHEVË	Ujësjiellës	234	2
TOTAL		2,352	18

Vërejtje:

Sipas të dhënave nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), gjatë vitit raportues janë marrë gjithsej 2,352 mostra të ujit për analiza laboratorike. Nga këto, 18 mostra nuk kanë përmbushur standardet për ujin e pijshëm, që përbën 0.76% të totalit të mostrave të analizuara. Keto mostra janë si pasojë e rritjes së turbullitetit (si shkak i reshjeve dhe vërshimeve)

Rrjedhimisht, 99.24% e mostrave të testuara rezultojnë brenda kufijve të lejuar dhe në përputhje me standardet për cilësinë e ujit të pijshëm, duke dëshmuar një nivel të lartë sigurie dhe kontrolli të cilësisë së ujit në zonën e shërbimit.

VI. DEPARTAMENTI KOMERCIAL

6.1 PERFORMANCAT - 2025

6.1.1 NUMRI I KONSUMATORËVE

Numri i konsumatorëve ka shënuar një rritje vjetore prej 5.4% (+3,312) krahasuar me vitin e kaluar, duke treguar zgjërime të bazës së konsumatorëve.

Në raport me Planin e Biznesit, numri i konsumatorëve ka realizuar praktikisht objektivin (100.26%), me një tejkalim minimal prej 168 konsumatore.

Tabela nr. 6 – Numri i Konsumatorëve- 2024-2025

NUMRI I FATURAVE TË LËSHUARA			
No.	Të dhënat	2024	2025
1	Shtëpiak	54,362	57,351
2	Ndryshimi		2,989
3	Ndryshi. %		5.5%
4	Kome.-Indu.	6,864	7,186
5	Ndryshimi		322
6	Ndryshi. %		4.7%
7	Institucional	355	356
8	Ndryshimi		1
9	Ndryshi. %		0.3%
10	TOTAL	61,581	64,893
11	Ndryshimi		3,312
12	Ndryshi. %		5.38%

Diagrami nr. 3 – Numri i Konsumatorëve- 2024-2025





Tabela nr. 7 – Numri i Konsumatorëve – Caqet 2025

NUMRI I FATURAVE TË LËSHUARA			
No.	Të dhënat	JAN-DHJET - 2025	JAN-DHJET – 2025 (PB)
1	Shtëpiak	57,351	57,270
2	Ndryshimi		81
3	Ndryshi. %		0.14%
4	Kome.-Indu.	7,186	7,092
5	Ndryshimi		94
6	Ndryshi. %		1.33%
7	Institucional	356	363
8	Ndryshimi		-7
9	Ndryshi. %		-1.93%
10	TOTAL	64,893	64,725
11	Ndryshimi		168
12	Ndryshi. %		0.26%

Diagrami nr. 4 – Numri i Konsumatorëve – Caqet 2024



6.1.2 FATURIMI – m³

Gjatë vitit 2025, faturimi në m³ rezulton pothuajse i pandryshuar krahasuar me vitin e kaluar (-0.1%), duke reflektuar stabilitet në aktivitetin bazë dhe ruajtje të nivelit të faturimit. Megjithatë, në krahasim me Planin e Biznesit, evidentohet një nënperformancë prej 7.96% (-737,996 m³), me realizim prej 92.04% të planit. Ky devijim lidhet kryesisht me vështirësitë në furnizimin e rregullt me ujë në tri lagje kryesore, ku nuk ka qenë e mundur sigurimi i furnizimit 24/7 gjatë periudhave të caktuara të vitit. Gjithashtu, rënia e nivelit të burimeve dhe temperaturat e larta gjatë sezonit veror kanë ndikuar në kufizimin e volumit të ujit të disponueshëm për shpërndarje.

Pavarësisht kësaj, performanca operative dhe financiare gjatë vitit 2025 ka qenë stabile dhe pozitive, me nivel të inkasimit që ka tejkaluar pritshmëritë strategjike, duke reflektuar përmirësim në disiplinën e pagesave dhe menaxhimin e borxheve. Në këtë kontekst,

prioritet strategjik mbetet përmirësimi i realizimit të faturimit dhe rritja e volumit të shitjeve përmes përmirësimit të furnizimit, rishikimit më realist të planifikimit dhe integritit të faktorëve klimatikë dhe sezonalë në projeksionet e ardhshme, duke vijuar njëkohësisht monitorimin e vazhdueshëm të arkëtimit.

Tabela nr. 8 – Faturimi m3- 2024-2025

FATURIMI - m3			
No.	Të dhënat	JAN-DHJET - 2024	JAN-DHJET - 2025
1	Shtëpiak	7,222,613	7,096,292
2	Ndryshimi		(126,321)
3	Ndry. %		(1.7)
4	Kome.-Indu.	836,377	872,056
5	Ndryshimi		35,679
6	Ndry. %		4.3
7	Institucional	485,020	568,383
8	Ndryshimi		83,363
9	Ndry. %		17.2
10	TOTAL	8,544,010	8,536,731
11	Ndryshimi		(7,279)
12	Ndry. %		-0.1%

Diagrami nr. 5 – Faturimi m3- 2024 -2025





Tabela nr. 9 – Caqet 2025

FATURIMI - m3			
No.	Të dhënat	JAN-DHJET - 2025	JAN-DHJET - 2025 (PB)
1	Shtëpiak	7,096,292	7,821,520
2	Ndryshimi		-725,228
3	Ndry. %		-9.27%
4	Kome.-Indu.	872,056	860,449
5	Ndryshimi		11,607
6	Ndry. %		1.35%
7	Institucional	568,383	592,757
8	Ndryshimi		-24,374
9	Ndry. %		-4.11%
10	TOTAL	8,536,731	9,274,726
11	Ndryshimi		-737,995
12	Ndry. %		-7.96%

Diagrami nr. 6 – Caqet 2025



6.1.3 FATURIMI – €

Gjatë vitit 2025, performanca operative dhe financiare e KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a. ishte në përgjithësi stabile dhe pozitive. Faturimi në m³ rezultoi pothuajse i pandryshuar krahasuar me vitin paraprak (-0.1%), duke reflektuar stabilitet në aktivitetin bazë dhe ruajtje të nivelit të shitjes së ujit. Megjithatë, krahasuar me Planin e Biznesit, evidentohet një nënperformancë prej 7.96% (-737,996 m³), me realizim prej 92.04% të planit.

Ky devijim lidhet kryesisht me vështirësitë në furnizimin e rregullt me ujë në tri lagje kryesore, ku nuk ka qenë e mundur sigurimi i furnizimit 24/7 gjatë periudhave të caktuara të vitit. Situata është ndikuar nga rënia e nivelit të burimeve ujore dhe kushtet klimatike, veçanërisht gjatë sezonit të verës, çka ka kufizuar mundësinë për rritjen e volumit të faturimit.

Nga ana tjetër, inkasimi ka tejkaluar pritshmëritë strategjike, duke reflektuar përmirësim në disiplinën e pagesave dhe menaxhimin e borxheve. Në këtë kontekst, prioritet strategjik mbetet përmirësimi i realizimit të faturimit dhe rritja e volumit të shitjeve, përmes përmirësimit të furnizimit, rishikimit më realist të planifikimit dhe marrjes në konsideratë të faktorëve klimatikë dhe sezonalë në projeksionet e ardhshme.

Tabela nr. 10 – Faturimi € - 2024-2025

FATURIMI - €			
No.	Të dhënat	JAN-DHJET - 2024	JAN-DHJET - 2025
1	Faturimi-€	5,708,069.62	5,994,804.73
2	Total- Shte.	4,375,852.76	4,589,167.25
3	Ndryshimi		213,314.49
4	Ndry. %		4.9%
5	Total- kome.	893,066.82	915,197.00
6	Ndryshimi		22,130.18
7	Ndry. %		2.5%
8	Total-Inst.	439,150.04	490,440.48
9	Ndryshimi		51,290.44
10	Ndry. %		11.7%
11	Te tjera	49,821.78	47,921.17
12	Total	5,757,891.40	6,042,725.90
13	Ndryshimi		284,834.50
14	Ndry. %		4.9%


Diagrami nr. 7 – Faturimi €- 2024 -2025



Tabela nr. 11 – Faturimi €- Caqet 2025

FATURIMI - €			
No.	Të dhënat	JAN-DHJET - 2025	JAN-DHJET - 2025 (PB)
1	Faturimi-€	5,994,804.73	6,399,855.23
2	Total- Shte.	4,589,167.25	4,986,409.05
3	Ndryshimi		-397,241.80
4	Ndry. %		-7.97%
5	Total- kome.	915,197.00	892,916.85
6	Ndryshimi		22,280.15
7	Ndry. %		2.50%
8	Total-Inst.	490,440.48	520,529.33
9	Ndryshimi		-30,088.85
10	Ndry. %		-5.78%
11	Te tjera	47,921.17	26,740.00
12	Total	6,042,725.90	6,426,595.23
13	Ndryshimi		-383,869.33
14	Ndry. %		-5.97%

Diagrami nr. 8 – Faturimi €- Caqet 2025



6.1.4 ARKËTIMI – €

Tabela nr. 12 – Arkëtimi €- 2024 -2025

No.	Të dhënat	JAN-DHJET - 2024	JAN-DHJET – 2025
1	Total- Shtëpiak	4,664,059.38	4,897,756.60
2	Ndryshimi		233,697.22
3	Ndry. %		5.0%
4	Total-Komercial-Industrial	994,350.11	961,005.96
5	Ndryshimi		(33,344.15)
6	Ndry. %		-3.4%
7	Total Institucional	402,390.04	396,538.39
8	Ndryshimi		(5,851.65)
9	Ndry. %		-1.5%
10	Total - ujë	6,060,799.53	6,255,300.95
11	Ndryshimi		194,501.42
12	Ndry. %		3.2%
13	Te tjera	40,824.10	39,654.34
14	Ndryshimi		(1,169.76)
15	Ndry. %		-2.9%
16	TOTAL	6,101,623.63	6,294,955.29
17	Ndryshimi		193,331.66
18	Ndry. %		3.17%

Rënia e inkasimit në sektorin institucional gjatë vitit 2025 arsyetohet kryesisht me moskryerjen e obligimeve financiare nga:

- Shkollat fillore dhe të mesme
- Spitali i Qarkut Daut Mustafa

Drejtoria e Shërbimeve Publike në Prizren dhe Malishevë, Pra, rënia në sektorin institucional nuk lidhet me ulje të konsumit, por kryesisht me mosrealizim të pagesave nga institucionet përkatëse. Kjo situatë ka ndikuar në performancën financiare dhe në rrjedhën e likuiditetit të kompanisë.

Diagrami nr. 9 – Arkëtimi €- 2024 -2025




Tabela nr. 13 – Arkëtimi €- Caqet 2025

No.	Të dhënat	JAN-DHJET - 2025	JAN-DHJET - 2025 (PB)
1	Total- Shtëpiak	4,897,756.60	4,746,593.49
2	Ndryshimi		-151,163.11
3	Ndry. %		-3.18%
4	Total-Komercial-Industrial	961,005.96	866,681.15
5	Ndryshimi		-94,324.81
6	Ndry. %		-10.88%
7	Total Institucional	396,538.39	494,818.28
8	Ndryshimi		98,279.89
9	Ndry. %		19.86%
10	Total - ujë	6,255,300.95	6,108,092.92
11	Ndryshimi		-147,208.03
12	Ndry. %		-2.41%
13	Te tjera	39,654.34	25,150.15
14	Ndryshimi		-14,504.19
15	Ndry. %		-57.67%
16	TOTAL	6,294,955	6,133,243
17	Ndryshimi		-161,712
18	Ndry. %		-2.64%

Diagrami nr. 10 – Arkëtimi €- Caqet 2025



6.2 KOMENTET KRYESORE NGA DEPARTAMENTI KOMERCIAL

6.2.1 AKTIVITETET KRYESORE

Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike ndërsa ankesat komerciale të konsumatorëve janë shqyrtuar sipas kohës dhe prioritetit të tyre,

Janar-Dhjetor 2025 HRJ

1. Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	2173
1.1 Rrjedhje e ujit	numër	1294
1.2 Mungese e ujit	numër	780
1.3 Rënie e presionit	numër	33
1.4 Cilësia e ujit	numër	20
1.6 Të tjera	numër	46
2. Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	814
2.1 Kontestim i borxhit, fatures	numër	543
2.2 Verifikim i leximit të ujematesit /te tjera	numër	258
2.3 Te tjera	numer	13

Me intensitet të shtuar , kanë vazhduar kontrollet në teren nga ekipi i inspektimit tek konsumatorët, ku janë shpërndarë verejtje për nderpreje të shërbimit, legalizim të konsumatorëve, ankesa të konsumatorëve, inkasim e borgjeve dhe aktivitete të tjera duke i ndërruar terrenet e lexuesve.

RAPORT I EKIPEVE TË INSPEKTIMIT

Njesite operative	Dergimi i verejtjeve	Konsumatorët e legalizuar/ regjistruar	Lidhjet e paligjshme të zbuluara	Nr. i shkyçjeve për mos pagesë	Verefikimi i leximit të ujmatesave	Lexime të gabuara	Rastet e dorezuara për gjykatë/përmbarim	Vizita nga ankesat/kerkesat konsumatoreve	Riprogramimi
Prizren	19683	2026	823	3327	6949	47	149	549	51
Suharek	5150	389	253	1044	4291	14	51	99	10
Malisheve	2144	226	55	181	2577	30	53	96	71
Dragash	114	48	12	12	206	0	2	2	9
HRJ	27091	2689	1143	4564	14023	91	255	746	141

RAPORT PËR RASTET E DËRGUARA NË PËRMBARIM (Janar-Dhjetor 2025)

Ky raport paraqet rastet e dërguara në përmbarim sipas njësive punuese, për vitin 2025

NJËSIA	NR -2025	2025-TOTALI (€)	2025 INKASIM (€)
PRIZREN	151	155,379.35	111,695.90
MALISHEVË	45	34,328.03	11,713.17
SUHAREKË	85	67,609.39	32,085.03
DRAGASH	0	0	945.72
TOTALI	281	257,316.77	156,439.82

Problemet e hasura gjatë periudhës raportuese

- Dyert e mbyllura dhe pamundësia për lexim të rregullt të ujëmatësve – Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në saktësinë e faturimit dhe krijon mospërputhje në evidencë. Nevojitet koordinim më i mirë me konsumatorët, njoftime paraprake dhe aplikimi i metodave alternative të leximit për të shmangur faturimin e vlerësuar.
- Vështirësi në shkyçjen për mos pagesë – Moslejimi i qasjes nga konsumatorët vështirëson zbatimin e procedurave ligjore për arkëtim, duke ndikuar negativisht në disiplinën e pagesave dhe në stabilitetin financiar të ndërmarrjes.
- Mos pagesa, me theks të veçantë nga institucionet dhe konsumatorët me marrëveshje këstesh – Vonesat në pagesa dhe vështirësitë financiare rrisin nivelin e borxheve të papaguara, duke krijuar presion mbi rrjedhën e parasë dhe duke kërkuar masa më efikase për menaxhimin e borxheve.
- Moszgjidhja e borxhit ndërmjet shitësit dhe blerësit të pronës – Mungesa e qartësisë në transferimin e obligimeve financiare gjatë ndërrimit të pronësisë shkakton konteste dhe vonesa në pagesa; nevojitet rregullim më i qartë kontraktual dhe administrativ.
- Rrjedhje dhe dëmtime në ujëmatës dhe brenda pronës – Këto probleme shkaktojnë humbje të ujit dhe rritje të faturave për konsumatorët, duke kërkuar reagim të shpejtë për identifikim dhe sanim.
- Rrjedhje të pa riparuar për periudha të gjata – Mosriparimi në kohë rrit humbjet teknike dhe kostot operative, si dhe ndikon negativisht në furnizimin e qëndrueshëm me ujë.
- Ujëmatës të amortizuar – Pajisjet e vjetruara që nuk regjistrojnë saktë konsumin çojnë në faturim jo të drejtë dhe humbje financiare; zëvendësimi i tyre është i domosdoshëm për rritjen e saktësisë së matjes.
- Konsumatorë sezonalë që jetojnë jashtë vendit – Konsumi i parregullt dhe mungesa fizike e konsumatorëve vështirësojnë leximin e ujëmatësve, faturimin korrekt dhe planifikimin e saktë të konsumit.

Konsumatorët që janë faturuar vetëm me tarif fikse për Dhjetor të viti 2025

Njësia	Nr Total 0 m3	Nr total i Konsumatorve	% dhjetor me 0m3
DRAGASH	1038	1729	60.03
MALISHEVE	3290	6624	49.67
PRIZREN	13682	44796	30.54
SUHAREKE	6258	11838	52.86
Total	24268	64987	37.34

Masat e realizuara / mosrealizuara nga periudha paraprake

- Leximi me kohë i ujëmatësve tek të gjithë konsumatorët ku është siguruar qasja fizike në pajisje.
- Faturimi dhe shpërndarja e faturave për të gjithë konsumatorët në zonën e shërbimit.
- Zarfimi i faturave me qëllim mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me udhëzimet e Agjencisë për Informim dhe Privatësi.
- Printimi dhe dërgimi i vërejtjeve për shkyçje për konsumatorët me borxhe nën 200 €, si masë parandaluese për rritjen e arkëtimit.
- Monitorimi sistematik i konsumatorëve që kanë pranuar njoftime për shkyçje, me qëllim vlerësimin e reagimit dhe marrjen e masave të mëtejshme.
- Thirrje dhe njoftime për konsumatorët që nuk kanë përmbushur obligimet financiare pas riprogramimit të borxheve.
- Vazhdimi i bllobimit të ujëmatësve dhe nënshkrimi i kontratave të reja të shërbimit me konsumatorët.
- Shkyçja nga shërbimi e konsumatorëve të referuar tek përmbaruesi privat për borxhe të papaguara, në përputhje me procedurat ligjore.
- Identifikimi dhe trajtimi i rasteve sociale me vështirësi financiare, në bashkëpunim me institucionet përkatëse dhe në përputhje me politikat sociale në fuqi.

Masat e propozuara për periudhën në vazhdim

- Zarfimi i faturave nga lexuesit në terren për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Identifikimi dhe shkyçja e konsumatorëve pa ujëmatës që nuk kanë vendosur pajisjen edhe pas vërejtjeve zyrtare.
- Vizita në institucione publike dhe private që nuk kanë kryer pagesat, me qëllim rritjen e inkasimit.
- Dërgimi i rasteve tek përmbaruesi privat për konsumatorët që nuk përmbushin obligimet
- Printimi dhe shpërndarja e vërejtjeve për konsumatorët me borxh mbi 100 €.
- Intensifikimi i kontrolleve tek konsumatorët me konsum të raportuar 0 m³ për identifikimin e parregullive.

- Identifikimi i konsumatorëve me borxhe deri në 6 muaj dhe vizita në terren për nxitjen e pagesave.
- Piketimi i zonave me nivel të ulët pagesash, veçanërisht tek amvisëritë dhe bizneset.
- Vazhdimi i thirrjeve dhe mesazheve për konsumatorët që nuk i përmbahen kushteve të kontratës.
- Shpërndarja e paralajmërimeve para procedurave përbarimore dhe riorganizimi i terreneve sipas prioriteteve.
- Vizita tek bizneset me borxhe ose që nuk respektojnë marrëveshjet me këste.
- Mbështetja e lexuesve nga ekipi i kontrollit në rastet problematike.
- Monitorimi i punës së lexuesve përmes përmirësimit të metodave në terren.
- Regjistrimi dhe legalizimi i konsumatorëve që shfrytëzojnë shërbimet pa kontratë.
- Raportimi në kohë reale për ujëmatës jofunksionalë dhe rrjedhjet e identikuara.
- Vazhdimi i bllobimit të ujëmatësve për parandalimin e keqpërdorimeve.

VII DEPARTAMENTI I FINANCEVE

7.1 KOMENTET KRYESORE NGA DEPARTAMENTI I FINANCEVE

7.1.1 AKTIVITETET KRYESORE

Ky raport përfshin të gjitha aktivitetet e realizuara nga Shërbimi Financiar gjatë vitit fiskal 2025, në përputhje me rregulloren e punës së kompanisë dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Aktivitetet janë zhvilluar duke u bazuar në regjistrime të rregullta dhe të sakta financiare, respektim të obligimeve ligjore dhe angazhim të vazhdueshëm për përmirësimin e performancës financiare të kompanisë.

Gjatë pjesës së parë të vitit 2025, Departamenti Financiar ka qenë i angazhuar në procesin e certifikimit dhe auditimit të pasqyrave financiare. Në kuadër të këtij procesi është përgatitur dhe ofruar i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga auditorët e jashtëm, janë realizuar barazimet e nevojshme të llogarive, janë verifikuar evidencat kontabël dhe është siguruar përputhshmëria e plotë e pasqyrave financiare me standardet dhe kërkesat ligjore në fuqi. Gjithashtu, janë adresuar dhe implementuar rekomandimet e dala nga raporti i auditimit, me qëllim përmirësimin e kontroleve të brendshme dhe rritjen e transparencës financiare.

Në pjesën e dytë të vitit fiskal 2025, kompania ka qenë subjekt i kontrollit nga Administrata Tatimore e Kosovës për periudhën 2020–2024. Gjatë këtij procesi, Shërbimi Financiar ka përgatitur dhe dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar, përfshirë librat e blerjes dhe shitjes, deklaratat e TVSH-së, deklaratat e tatimit në paga, evidencat kontabël, kontratat dhe dokumente tjera mbështetëse. Është ofruar bashkëpunim i plotë dhe sqarime të vazhdueshme për zyrtarët tatimorë gjatë gjithë procesit të kontrollit, duke siguruar menaxhim korrekt dhe profesional të procedurës së inspektimit. Kontrolli ishte i koncentruar në deklaratat CD dhe TVSH, ku pas kontrollit kompania është ngarkuar me obligim tatimorë

(detyrim tatimor, interes dhe ndëshkim) rreth 110 mijë euro për katër vitet fiskale 2020-2023. Pra, nuk është pranuar amortizimi sipas librava të mbajtur të aseteve sipas rivlerësimit të Grand Thornton, por kanë aplikuar amortizimin sipas kontrolleve të viteve të mëhershme, pra ato para vitin 2010 dhe atij të 2017.

• Punët e rregullta operative gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025 janë realizuar në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike aktivitetet e zakonshme financiare, si:

- Regjistrimi ditor i arkave në bazë ditore, regjistrimet e furnitorëve, depove dhe aseteve për muajt përkatës;
- Regjistrimet ditore në kontabilitet të hyrje/daljeve të materialit në depo;
- Përgatitja e raporteve mujore, tremujore dhe vjetore për institucionet përkatëse;
- Hapja, përgatitja e pagave për muajt përkatës, kontrollimi, barazimi dhe verifikimi i regjistrit të të punësuarve;
- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendja e arkës në lidhje me inkasimet ditore nga amvisëria dhe bizneset, gjendja e llogarive bankare, kontimi dhe barazimet përkatëse;
- Barazimet e rregullta të arkave mobile me dorëzimin e mjeteve në bankë apo në arkën kryesore;
- Barazimet e rregullta të furnitorëve dhe realizimi i pagesave sipas obligimeve të krijuara nga blerjet;
- Pranimi, kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, aprovimi i tyre dhe shpërndarja e materialit të blerë;
- Kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet, si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet pas verifikimeve përkatëse;
- Regjistrimi i investimeve kapitale dhe raportimi i tyre;
- Plotësimi i librit të blerjes dhe shitjes sipas kërkesave të ATK-së për muajin përkatës;
- Deklarimi i rregullt i tatimeve, TVSH-së, tatimeve në paga dhe obligimeve tjera sipas ligjeve në fuqi;
- Takimet e rregullta me menaxhmentin e kompanisë lidhur me performancën financiare dhe prezantimi i rekomandimeve për përmirësimin e efikasitetit dhe stabilitetit financiar;
- Aktivitetet e nevojshme për përmbylljen e vitit fiskal 2025, përfshirë barazimet përfundimtare të llogarive dhe përgatitjen e dokumentacionit për raportim.

Gjatë gjithë vitit 2025, Shërbimi Financiar ka vepruar me përgjegjësi të lartë profesionale, duke siguruar menaxhim transparent të mjeteve financiare, respektim të obligimeve ligjore dhe mbështetje të vazhdueshme për menaxhmentin në procesin e vendimmarrjes dhe planifikimit financiar të kompanisë.

7.1.2 ARSYESHMËRIA E SHPENZIMEVE

Shpenzimet operative vjetore 2025 të ndërmarrjes, në krahasim me shpenzimet e vjetore 2024, janë më të larta;

Më poshtë do t'i cekim disa nga pozicionet, të cilat kanë lëvizur më së shumti dhe arsytet e rritjes apo rënies së tyre;

- Në pozicionin e pagave kemi një rritje prej 10% të shpenzimeve në krahasim me vitin e kaluar, për arsye se mesatarisht gjatë vitit 2025 është rritur numri i punëtorëve për 12 punëtorë. Gjithashtu, nga muaji maj, është rritur paga linerisht për të gjithë punëtorët për 50 € si dhe sigurimet shëndetësore, nga muaji prill, janë paguar 100 % nga kompania. Pra, kjo rritje ka ardhur edhe si rezultat i ngritjes së çmimeve në tërësi dhe ka qenë mëse e domosdoshme të bëhet një gjë e tillë;
- Edhe te pozicioni i energjisë elektrike kemi një rritje të lartë, pasi që nga muaji qershor i vitit 2025, me energji elektrike, jemi furnizuar dhe faturuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) KEK-u dhe me këtë rast ka ndryshuar edhe cmimi i energjisë, pra kompania KRU Hidroregjioni Jugor SH.A., sipas vendimit të ZRRE-së, ka kaluar në treg të lirë të energjisë. Pra si rezultat i kësaj, kemi një rritje totale vjetore të energjisë elektrike mbi 83 %;
- Rënie të lehtë kemi te shpenzimet tek pozicioni i derivateve në krahasim me vitin e kaluar, për 5 % janë më të ulëta, krejt këto shpenzime po varen nga aktiviteti i makinerisë së kompanisë, si dhe nga ajo më kryesorja është nga çmimi i derivateve;
- Rritje të lartë të shpenzimeve kemi edhe te kategoria e mirëmbajtjes në rrjet dhe në mirëmbajtjen e pompave. Në këtë vit, përveç intervenimeve në rrjet, kemi pasur edhe shumë intervenime elektrike pas defekteve të stacioneve të pompimit. Gjithashtu në këtë vit kemi pasur edhe një numër të madh të ndërrimit të ujëmatësave, gjë që të gjitha këto kanë ndikuar në rritje të shpenzimeve të këtij pozicioni;
- Rënie të shpenzimeve kemi te pozicioni i mirëmbajtjes së automjeteve, pra përveç mirëmbajtjes së defekteve dhe shpenzimeve të regjistrimit, rënie ka pasur për shkak se në vitin e kaluar kemi bërë edhe furnizim me goma të verës si dhe ato të dimrit afërsisht në vlerë prej 42 mijë euro, pothuajse për të gjitha automjetet e kompanisë. Pra kjo ka bërë që vitin e kaluar i kemi pasur shpenzimet më të larta;
- Ndërsa shpenzimet e taksave, i kemi pothuajse të njejta me vitin e kaluar, pra shpenzimet e anëtaresisë SHUKOS, ARRU dhe shpenzimet e tjera si ato të përmbaruesit e të tjera;
- Rënie të shpenzimeve kemi tek kategoria e kemikaleve dhe kategoria e shpenzimeve të tjera. Pra, në këtë kategori të shpenzimeve të tjera, përfshihen shpenzimet administrative, shpenzimet të jashtme profesionale, siç janë shpenzimet për mirëmbajtje të softuerit, mirëmbajtje për GPS, shpenzimet e provizioneve, ku në këtë vit kemi pasur më pak shpenzime të provizioneve. Por vlenë të theksohet se në vitin 2024 kemi paguar edhe taksën për lejen ujore ndaj MMPH-së, gjë që këtë vit nuk na kanë ngarkuar, por që pritet të na ngarkojnë në vitet pasuese;

Pra si përfundim, shpenzimet totale, për vitin 2025 kanë qenë më të larta në krahasim me vitin e kaluar, për arsytet e cekura më lartë.

Tabela nr. 15 – Shpenzimet 2024-2025

SHPENZIMET - €					
No.		JAN-DHJET - 2024	JAN-DHJET - 2025	DALLIMI	%
1	Total Shpenzimet Operative	4,989,756.84	6,158,805.93	1,169,049.09	23.43%
2	Pagat	3,054,944.84	3,349,210.70	294,265.86	9.63%
3	Rryma elektrike	1,041,751.95	1,905,711.34	863,959.39	82.93%
4	Shpen. e deriva	121,752.98	115,550.98	-6,202.00	-5.09%
5	Mirem. dhe ripari	272,763.78	328,267.26	55,503.48	20.35%
6	Mirem. e automje	133,633.38	102,480.53	-31,152.85	-23.31%
7	Shpen.e taksave	109,703.00	111,324.45	1,621.45	1.48%
8	Kemikaliet	26,132.64	17,977.24	-8,155.40	-31.21%
9	Shpenzimet e tjera	229,074.27	228,283.43	-790.84	-0.35%

Diagrami nr. 11 – Shpenzimet 2024-2025





Tabela nr. 16 – Shpenzimet 2025- Caqet 2025

SHPENZIMET - €					
No.	Të dhënat	JAN-DHJET - 2025	JAN-DHJET - 2025 (PB)	DALLIMI	%
1	Total Shpenzimet Operative	6,158,805.93	5,806,409.19	352,396.74	5.72%
2	Pagat	3,349,210.70	3,283,638.38	65,572.32	1.96%
3	Rryma elektrike	1,905,711.34	1,735,141.58	170,569.76	8.95%
4	Shpen. e deriva	115,550.98	113,170.80	2,380.18	2.06%
5	Mirem. dhe ripari	328,267.26	230,000.00	98,267.26	29.94%
6	Mirem. e automje	102,480.53	85,000.00	17,480.53	17.06%
7	Shpen.e taksave	111,324.45	113,037.67	-1,713.22	-1.54%
8	Kemikaliet	17,977.24	26,420.76	-8,443.52	-46.97%
9	Shpenzimet e tjera	228,283.43	220,000.00	8,283.43	3.63%

Diagrami nr. 12 – Shpenzimet 2025- Caqet 2025



VIII PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE

8.1 PERFORMANCAT 2024-2025

KRU „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A

Tabela nr. 17 – Performancat - 2024-2025- Caqet 2025

MUAJI	JAN-DHJETOR - 2024	JAN-DHJETOR - 2025	NDRYSHIMI	NDRY.%	JAN-DHJETOR - PB	NDRYSHIMI	NDRY.%	REALIZIMI- %
<i>Prodhimi m3</i>	31,186,130	35,130,579	3,944,449	12.6%	32,638,341	2,492,238	7.64%	107.64%
<i>Faturimi m3</i>	8,544,010	8,511,988	-32,022	-0.4%	9,274,727	-762,739	-8.22%	91.78%
<i>Faturimi nga uji €</i>	5,708,069.62 €	5,994,804.73 €	286,735.11 €	5.0%	6,399,855.23 €	-405,050.50 €	-6.33%	93.67%
<i>Faturimi- te tjera €</i>	49,821.78 €	47,921.17 €	-1,900.61 €	-3.8%	26,740.00 €	21,181.17 €	79.21%	179.21%
<i>Faturimi Total €</i>	5,757,891.40 €	6,042,725.90 €	284,834.50 €	4.9%	6,426,595.23 €	-383,869.33 €	-5.97%	94.03%
<i>Inkasimi nga uji €</i>	6,060,799.53 €	6,255,300.95 €	194,501.42 €	3.2%	6,108,092.92 €	147,208.03 €	2.41%	102.41%
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	40,824.10 €	39,654.34 €	-1,169.76 €	-2.9%	25,150.15 €	14,504.19 €	57.67%	157.67%
<i>Inkasimi Total €</i>	6,101,623.63 €	6,294,955.29 €	193,331.66 €	3.2%	6,133,243.07 €	161,712.22 €	2.64%	102.64%
<i>Nr. i Konsumator</i>	61,581	64,893	3,312	5.4%	64,725	168	0.26%	100.26%
<i>% e inkasimit</i>	106.2%	104.3%	-1.8%		95.4%	8.9%	9.33%	109.33%
<i>Shpenzimet</i>	4,989,756.84 €	6,158,805.93 €	1,169,049.09 €	23.4%	5,806,409.19 €	352,396.74 €	6.07%	94.28%
<i>Pagat</i>	3,054,944.84 €	3,349,210.70 €	294,265.86 €	9.6%	3,283,638.38 €	65,572.32 €	2.00%	98.04%
<i>Rryma elektrike</i>	1,041,751.95 €	1,905,711.34 €	863,959.39 €	82.9%	1,735,141.58 €	170,569.76 €	9.83%	91.05%
<i>Shpe. e derivate</i>	121,752.98 €	115,550.98 €	-6,202.00 €	-5.1%	113,170.80 €	2,380.18 €	2.10%	97.94%
<i>Miremb. Dhe ripar</i>	272,763.78 €	328,267.26 €	55,503.48 €	20.3%	230,000.00 €	98,267.26 €	42.72%	70.06%
<i>Miremb, e automje</i>	133,633.38 €	102,480.53 €	-31,152.85 €	-23.3%	85,000.00 €	17,480.53 €	20.57%	82.94%
<i>Shpen. E taksave</i>	109,703.00 €	111,324.45 €	1,621.45 €	1.5%	113,037.67 €	-1,713.22 €	-1.52%	101.54%
<i>Kemikalet</i>	26,132.64 €	17,977.24 €	-8,155.40 €	-31.2%	26,420.76 €	-8,443.52 €	-31.96%	146.97%
<i>Shpenzimet tjera</i>	229,074	228,283.43 €	-790.84 €	-0.3%	220,000.00 €	8,283.43 €	3.77%	96.37%
<i>UPF në m3</i>	22,642,120	26,618,591	3,976,471	17.6%	23,363,614	3,254,977	13.93%	87.77%
<i>UPFr ne %</i>	72.6%	75.8%	3.17%		71.6%	4.19%		94.47%
<i>Mbulimi operativ</i>	1.22	1.02	-0.20	-16.4%	1.06	-0.03		96.76%
<i>Mbulimi operativ- €</i>	1,111,866.79 €	136,149.36 €	-975,717.43 €	-87.8%	326,833.88 €	-190,684.52 €	-58.34%	41.66%

8.2 DRAFT PASQYRAT FINANCIARE – 2024-2025

KRU Hidroregjioni Jugor SH.A., Prizren

Draft Pasqyra e gjendjes financiare 2025

	Shënimi	31 Dhjetor 2025 (në EURO)	31 Dhjetor 2024 (në EURO)
ASETET			
Asetet jo-qarkulluese			
Prona, impiantet dhe pajisjet	4	41,843,543.85	38,190,648.54
Asetet e paprekshme	5	46,736.81	46,736.81
		41,890,280.66	38,237,385.35
Asetet qarkulluese			
Stoqet	6	774,024.84	616,209.61
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera,neto	7	480,022.81	795,732.63
Paraja në dorë dhe në bankë	8	650,476.07	1,381,496.33
		1,904,523.72	2,793,438.57
Gjithsej asetet		43,794,804.38	41,030,823.92
EKUITETI DHE DETYRIMET			
Ekuiteti i aksionarëve			
Kapitali aksionar	9	25,000.00	25,000.00
Rezervat	10	18,902,128.78	19,205,212.30
Fitimet/(Humbjet) e akumuluar		(6,787,085.56)	(5,962,701.64)
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve		12,140,043.22	13,267,510.66
Detyrimet			
Detyrimet jo-qarkulluese			
Grantet e shtyera	11	30,309,422.55	26,460,227.96
		30,309,422.55	26,460,227.96
Detyrimet qarkulluese			
Huazimet – pjesa afatshkurtër	12	868,393.40	-
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	15	298,755.33	1,141,877.93
Detyrimet tjera		169,840.57	158,357.91
Provizionet	13	8,349.46	2,849.46
		1,345,338.76	1,303,085.30
Gjithsej detyrimet		31,654,761.31	27,763,313.26
Gjithsej kapitali dhe detyrimet		43,794,804.53	41,030,823.92

KRU Hidroregjioni Jugor SH.A., Prizren

Draft Pasqyra e fitimit apo humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse

	Shënimi	Me 31 Dhjetor 2025	Me 31 Dhjetor 2024
Të hyrat nga shitjet	14	6,030,927.0	5,737,861
Të hyrat nga grantet	15	1,594,621.2	407,464
Te hyrat nga subvencionet	16	-	2,700
Të hyrat tjera	16	16,819.0	65,913
		7,642,367.1	6,213,938
Shpenzimet operative			
Zhvlërësimi dhe amortizimi	4,5	(2,604,509.5)	(1,368,029)
Shpenzimet e personelit	17	(3,348,953.8)	(3,054,945)
Energjia elektrike		(1,905,711.3)	(1,041,778)
Shpenzimet e mirëmbajtjes		(431,300.1)	(378,676)
Shpenzimet e prodhimit te ujit		(27,214.2)	(43,709)
Provizionet ligjore		(5,500.0)	-
Shpenzimet e derivateve	14	(115,551.0)	(120,855)
Shpenzimet e tjera operative	22	(327,949.2)	(379,728)
		(8,766,689.1)	(6,387,719)
Fitimi nga operacionet		(1,124,322.0)	(173,781)
Shpenzimet/ (të hyrat) financiare,neto		(3,144.9)	(20,110)
Fitimi para tatimit		(1,127,466.8)	(193,891)
Tatimi në fitim	24	-	-
Fitim neto për vitin		(1,127,466.8)	(193,891)

Te hyra tjera gjithëpërfshirëse për vitin

Zërat qe nuk klasifikohen ne fitim apo humbje

Te ardhurat e liruara nga rivlerësimi i pronës, impianteve dhe paisjeve	10	303,083.5	321,855.32
Gjithsej te hyra gjithëpërfshirëse për vitin		(824,383.3)	127,964.36

IX DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

9.1 KOMENTET KRYESORE

- Identifikimi i mangësive dhe zbrazësive të Rregulloreve të Kompanisë.
- Përgatitja e Rregullores së Kompanisë për pagat;
- Autorizime të ndryshme për përfaqësime dhe për punë tjera;
- Takime zyrtare me Përmbartuesit Privat, ku janë diskutuar problemet me të cilat ballafaqohemi gjatë punës;
- Përfaqësime të Kompanisë në Gjykata;
- Propozime për Përmbartim, Përgjigje në Prapësim, Konstatime, Vendime, Autorizime, Marrëveshje, Kërkesa, Njoftime, si dhe shkresa tjera të cilat i kemi adresuar tek institucionet e ndryshme;

Tabela nr. 18 – Numri i punëtorëve -2025

Nr.	VITI	2024	2025
	NJËSIA PUNUESE		
1	PRIZREN	238	248
2	SUHAREKË	38	38
3	DRAGASH	16	15
4	MALISHEVË	32	33
5	HIDROREGJIONI	324	334
6	NDRYSHIMI		10
7	NDRSHI. - %		3.1%

Diagrami nr. 13 – Numri i punëtorëve -2025





Tabela nr. 19 – Numri i punëtorëve -2025

Nr.	VITI	2025	2025 (PB)
	NJËSIA PUNUESE		
1	PRIZREN	248	260
2	SUHAREKË	38	39
3	DRAGASH	15	18
4	MALISHEVË	33	32
5	HIDROREGJIONI	334	349
6	NFRYSHIMI		15
7	NDRSHI. - %		-4.29%

Diagrami nr. 14 – Numri i punëtorëve -2025



AKTIVITETET NGA BURIMET NJERËZORE JANAR-DHJETOR - 2025

NR	Përshkrimi	Numri i punëtorëve
1	Pushim vjetor	280
2	Pushim mjekësor	148
3	Pushim pa pagesë	12
4	Pushimi i lehonisë	4
5	Pushimi i lehonisë për burra	6
6	Pushim mjekësor me kompensim	3
7	Pushim për rast vdekje	8
8	Vërejtje për punëtorët	17
9	Pensionim	5
10	Janë punësuar	20
11	Shkarkim dhe ndërprerje e kontratës	0
12	Ndërprerje e kontratës me vetë dëshirë	5
13	Rast vdekje (punëtori i HRJ)	0
14	Largimi i përkohshëm	4

9.2 ZYRA LIGJORE

LËNDËT TË CILAT KËRCËNOJNË KOMPANINË

Tabela nr. 20 –Lendët që kërcënojnë kompaninë -2025

Nr.	Kontesti	Vërejtje
1	Faturim i pabaze	Gjykatë Themelore Gjakovë
2	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë
3	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë
4	Padi – Kontest lidhur me borxhin e ujit	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë
5	Padi – kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren.
6	Padi për shkak të vërtetimit të pronësisë	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
7	Padi – kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
8	Padi – kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
9	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
10	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
11	Padi për Vërtetim dhe dislokim	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
12	Padi – Kontest pronësorë	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Dragash
13	Padi për vërtetimin e dëmit në emër të paluajtshmërisë së eksproprijimit jo të plotë	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
14	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Malishevë
15	Padi për kthimin e mjeteve	Lënda gjendet në Gjykatën Komerciale
16	Padi për anulim të	Lënda gjendet në
	Vendimit Nr.930/20	Gjykatën Themelore në Prizren-Dega në Suharekë
17	Padi per Anulimin e Vendimit.	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
18	Padi per kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
19	Padi për	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
	Anulim e Vendimit	
20	Padi për anulimin e Vendimit.	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
21	Padi për kontest pune.	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
22	Padi për konflikt administrativ dhe kërkesë për shtyerje të ekzekutimit	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren

X DEPARTAMENTI I UN -ITUN

10.1 KOMENTET KRYESORE

10.1.1 FUSHËVEPRIMI I DEPARTAMENTIT TË -ITUN

Departamenti i UN- ne fusheveprimtarine e tijë perfshinë:

- Grumbullimin e ujerave te ndotura per qytetin e Prizrenit, Malisheves Suharekës dhe Dragashit permes sistemeve egzistuese dhe sistemeve te reja ne ndertim e siper,
- Mirembajtjen e ujerave te ndotura per qytetin e Prizrenit, Malisheves Suharekës dhe Dragashit permes sistemeve egzistuese dhe sistemeve te reja ne ndertim e siper,
- Konsolidimin e sistemeve egzistuese dhe Planifikimin e sistemeve te reja te kanalizimeve ne nivel regjional,
- Trajtimin e ujerave te ndotura permes Impianteve per trajtimin e ujerave te ndotura te cilat jane ndertuar, jane ne ndertim e siper dhe do te ndertohen ne te ardhmen.
- Konsolidimin e impianteve egzistuese dhe planifikimin e impianteve te reja centrale dhe parciale ne nivel regjional,
- Monitorimin dhe konsolidimin e ujerave industriale ne nivel regjional,
- Garantimin e parametrave te efluantit sipas direktivave dhe udhezimeve ne fuçi te cilat percaktojne shkallen e ndotjes e cila lejohet te shkarkohet ne trupat pritese.

Aktualisht jemi duke operuar me ITUN per qytetin e Prizrenit dhe jemi ne procedure te marrjes ne menaxhim Impiantin e Bukoshit-Suhereke dhe Impiantin e Kukit-Dragash.

1. STATUSI I PROJEKTEVE

Statusi i projektit Faza -I

- 1.1. Ndërtimi i kolektorit kryesor dhe interceptoreve në rrugë, ana e djathtë e rrjedhjes së lumbardhit.**

Statusi i projektit për Fazën I – Investimet per Fazën I, janë derguar ne kontabilitet per regjistrim ne bazen rregullatore te asetëve sipas raportit te dates 31.12.2024 me nr. prot. 5580/2024

- 1.2. Statusi i projektit të I.T.U.N-së – Faza II-të
Dizajnimi, Furnizimi dhe Ndërtimi i Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Ndotura në Prizren.**

Statusi i projektit për Fazën II – Investimet per Fazën II, janë derguar ne kontabilitet per regjistrim ne bazen rregullatore te asetëve sipas raportit te dates 31.12.2024 me nr. prot. 5580/2024, perkatesisht raportit te dates 15.12.2025 me nr. Prot. 4983/2025.

1.3. Statusi i projektit Masat Shoqeruese

Shërbimet konsulente për ngritjen institucionale dhe atë teknike për HRJ-në

Shërbimet konsulente për Masat Shoqeruese, janë derguar në kontabilitet për regjistrim në bazën rregullatore të aseteve sipas raportit të datës 31.12.2024 me nr. prot. 5580/2024

1.4. Statusi i projektit "Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në qytetin e Prizrenit" faza V dhe VI

Ky projekt është bërë i mundur falë bashkëpunimit ndërqeveritar në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale Gjermane, përmes KfW-së, e cila pandërprerë ka financuar projektet kryesore për qytetarët e Prizrenit.

Një ndër kushtet e përfitimit të këtij granti ka qenë edhe vendosja e rrjetit të kanalizimit në gjeoreferencë, konkretisht në sistemin e GIS-it me të gjitha imputet teknike, kjo është realizuar nga Departamenti ynë dhe aktualisht sistemi i rrjetit të kanalizimit në kompanin tonë mund të themi se është me i konsoliduari në nivel sektori.

Prandaj i jemi mirënjohës dhe falënderojmë taksapaguesit Gjermanë për ndihmën e pandërprerë e cila ka ndikuar pozitivisht në ngritjen socio-ekonomike për qytetarët e Kosovës e në veçanti për qytetarët e Prizrenit.

Emri i projektit	Kontrata e punës WC1.3 "Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit për qytetin e Prizrenit"
Nënshkrimi i kontratës:	07 nëntor 2022
Data e fillimit:	21 nëntor 2022
Vlera e kontratës:	4,297,232.00 Euro
Kompletimi i projektit:	18 muaj ose 547 ditë nga data e fillimit
Agjencioni financues:	KfW-Banka Gjermane për Zhvillim
Detyrat e kontratës:	Ndërrimi i rrjetit të kanalizimit duke filluar nga Ø150mm deri në Ø 800 mm
Gjatësia e ndërrimit të kanalizimit:	Rreth 7.7 km
Zona e projektit:	Qyteti i Prizrenit, zonat problematike në aspektin e funksionimit
Përfitues:	KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.a
Mbikqyrja:	Konsulenca e projektit SRP&Hidroing
Fillimi i punimeve në terren:	24.03.2023
Koha aktuale e kontratës:	547 ditë

Ditët e mbetura:	0 ditë
Koha e përfundimit:	21.05.2024
Periodha e defekteve DNP	21.05.2024
Koha e vazhduar e kontartes	08.11.2024

Koment 2.4.:

-Projekti ka përfunduar teresisht, aktualisht jemi në fazën e njoftimit të defekteve (DNP), e cila do të përfundojë më 31.03.2026,

-Projekti si tili është financuar 100% nga Granti të cilin e ka dhuruar Qeveria Gjermane përmes KfW-se, vlera e përfundimtare e projektit është 4,728,031.90 Euro,

- Nga 7722 m të cilat ishin parapare të rehabilitoheshin sipas kontratës, përfundimisht janë rehabilituar 6659.98 m duke filluar nga DN250mm deri në DN800mm, nga të cilat 3176.34 m, janë me metodën e INLINING-ut (vendosja e gypit brenda gypit ekzistues) dhe 3483.64 m me metodën e kanalit të hapur,

-Jane instaluar 249 cope puseta kryesore, 118 cope puseta inspektuese dhe 1521 kycje shtepiake,

-Jane furnizuar 1 kamionete me kiper dhe 2 pompa thithese ambulante për patsrim-zbrajje të pusetave, kaperderdhesve dhe na jane dhuruar 2 vetura të cilat deri në përfundim të projektit kanë qenë në shfrytëzim nga konsulenca e projektit.

-Nga projekti është hequr rruga Tirana me gjatësi prej 826.58m, materialin e të cilit kemi në dispozicion për përdorim në projektet tjera si dhe aktualisht është i deponuar në lokacionin e ITUN-se.

- Nga projekti është minusuar edhe distanca e vendosjes së pusetës prej 1m, ku me vendosjen e 249 pusetave kryesore janë zbritur 235.44m.

7722 m – sipas kontratës

6659.8 m – Jane instaluar

